



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER STELA R. DEMNERI  
ADRESA NR.5, GJIK KUQALI,  
PALL "FERAR", NR.1, NR.13  
TEL: 692437001



# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1319

Nr. koleksioni: 346

Tirane më 15/03/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

\*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2023051380036636554



A2023051380036636554

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË**

Nr. 1319 Rep.

Nr. 346 Kol.

12

**KONTRATË SHITJE KUOTË KAPITALI**

Sot, më date 15 / 03 / 2023, para meje Notere Stela R. Demneri, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tiranë, Nr.5, Gjik Kuqali, Pallati "Ferar", Nr.1, Nr.13, u paraqitën personalisht:

**PALA SHITËSE:**

**Znj. Ermela Kurti**, atësia Vangjel, amësia Ndone, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, me adresë Yzberish, Rr.'dhaskal Todri'; Nd. Ap.11; H. Shk.2; Kashar; Kashar; 1052; Tiranë, lindur më 30/12/1982, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033129783 dhe nr. personal **I26230013C**, në cilësinë e ortakut me 50% të kuotës së shoqërisë "**HASTA ENGINEERING**" sh.p.k, regjistruar si person juridik në me NUIS **M11511002J**, me adresë TIRANE Rruga Fadil Deliu, Kompleksi Gjoka, Shkalla Nr.2, Kati I, Ap.3.

**DHËNES PËLQIMI:**

**Znj. Luljeta Lejmoni**, atësia Dhimitër, amësia Agllai, shtetas Shqiptar, lindur në Përmet dhe banues në Tiranë, me adresë Artan Lenja; Nd. 17; H. 01; Ap. 01; Njësia Administrative Nr. 7; Tiranë, lindur më 05/11/1983, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Leternjoftim ID nr. personal **I36105018H**.

**PALA BLERËSE:**

**Z. Bledar Bregu**, atësia Robert, amësia Donika, shtetas Shqiptar, lindur në Ersekë, Kolonjë dhe banues në Tiranë, me adresë Artan Lenja; Nd. 17; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 13/03/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037886059 dhe nr. personal **I20313036P**.

Palët deklarojnë se identifikimi si mësipër pasqyron realitetin dhe se dokumentacioni i depozituar prej tyre është i përditësuar dhe lëshuar konform ligjit.

Sipas regjistrimit elektronik të QKB, shoqëria e përmendura më sipër është shoqëri me status aktiv, ortakët dhe drejtuesit ligjorë të tyre deklarojnë dhe garantojnë personalisht se kjo shoqëri vijon të jetë shoqëri aktive, nuk është në proces falimentimi, nuk janë në ndjekje penale, nuk janë nën sekuestro apo ndonjë formë tjetër e cila mund të kufizojë zotësinë juridike dhe për të vepruar të shoqërisë.

Palët, të informuar dhe në dijeni të plotë të pasojave ligjore në rast të një deklarimi të pavërtetë, pasi kanë marrë paraprakisht konsulencën ligjore dhe janë të njohur me rrjedhojat e aktit, kërkuar harimin e këtij akti notarial "Kontratë Shitje Kuotë Kapitali" si vijon:





A2023051380036636554

## KUSHTE PARAPRAKE:

1. Kapitali i shoqërisë **"HASTA ENGINEERING"** sh.p.k, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NUIS **M11511002J**, është në total ALL 500.000,00 (pesëqind mijë Lekë) dhe numër të përgjithshëm kuotash 2,00 (dy). Pala shitëse **Znj. Ermela Kurti** është ortak i 50 % (pesëdhjetë përqind) të kuotës së shoqërisë, me vlerë kapitali të barazvlefshme me ALL 250.000,00.
2. Ortaku **Znj. Ermela Kurti**, bazuar në të drejtën që i njeh ligji dhe statuti (bazuar kjo në ligjin nr. 9901/2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare', i ndryshuar, si dhe në Statutin e shoqërisë datë 05.09.2017), ka vendosur transferimin e plotë të kuotës së saj (pra 50 % - pesëdhjetë përqind) nëpërmjet shitjes, në favor të **Z. Bledar Bregu**.
3. Vlera e shitjes së kuotës me dakortësi të të dy palëve është **ALL 500.000 (pesëqind mijë lekë)**.
4. **Z. Bledar Bregu** deklaron se pranon të blejë 50 % të kuotës së shoqërisë **"HASTA ENGINEERING"** sh.p.k e cila aktualisht zotërohet plotësisht nga **Znj. Ermela Kurti**.
5. Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj sipas procedurave ligjore, administrative, **Z. Bledar Bregu** do të rezultojë ortak me 50% të kuotës së shoqërisë **"HASTA ENGINEERING"** sh.p.k.

## BAZA LIGJORE:

- Neni 761 e vijues të Kodit Civil;
- Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

### Neni 1 - Objekti i kontratës

1. Objekt i kësaj kontrate është transferimi i kuotës nëpërmjet shitjes nga pala shitëse tek pala blerëse, me vullnet të lirë e të plotë, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe statutin e shoqërisë
2. Konkretisht ortakja **Znj. Ermela Kurti**, zotëruese e 50% të kuotës së shoqërisë **"HASTA ENGINEERING"**, transferon nëpërmjet shitjes të gjithë kuotën e saj që zotëron në shoqërinë **"HASTA ENGINEERING"** sh.p.k dhe me nënshkrimin dhe regjistrimin e kësaj kontrate, pala shitëse heq dorë plotësisht nga kuota e saj e cila përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë **"HASTA ENGINEERING"** sh.p.k, duke ia kaluar këto të drejta sipas kësaj kontrate plotësisht palës blerëse shoqërisë **Z. Bledar Bregu**.
3. Vlera e shitblerjes së kuotës me dakortësi të palëve është **ALL 500.000 (pesëqind mijë lekë)**.

### Neni 2 - Çmimi i shitjes dhe mënyra e likuidimit

1. Çmimi i shitjes së kuotës që zotëron pala shitëse në shoqërinë **"HASTA ENGINEERING"** sh.p.k dhe që transferohen nëpërmjet kësaj kontrate në favor të palës blerëse është në total **ALL 500.000 (pesëqind mijë lekë)**.
2. Çmimi i shitjes në vlerën totale prej **ALL 500.000 (pesëqind mijë lekë)** është shlyer nga pala blerëse dhe palet nuk kanë ndonjë pretendim lidhur me këtë.

### Neni 3 - Garancitë

1. Pala shitëse **Znj. Ermela Kurti** deklaron dhe garanton se është e vetmja titullare e ligjshme e vlerës së kuotës që transferohet nëpërmjet kësaj kontrate dhe kuota është e lirë nga çdo barrë apo pretendim ligjor.

2





A2023051380036636554

2. Pala shitëse deklaron se ligji dhe statuti ja njohin të drejtën për në nënshkruar këtë kontratë kalimi kuotash ortakut të shoqërisë.
3. Në rast të një deklarimi të pavërtetë pala shitëse mban përgjegjësi personale sipas të gjithë parashikimeve ligjore në fuqi.
4. Deri në momentin që kjo kontratë të regjistrohet pranë QKB dhe kuotat të kalojnë përfundimisht në emër të palës blerëse, përgjegjësitë në lidhje me problematika juridike, ekonomike apo financiare të kuotave janë përgjegjësie e palës shitëse dhe pala shitëse përgjigjet në mënyrë solidare për cdo detyrim të mundshëm.

#### **Neni 4 - Heqja dorë nga të drejtat**

Pala shitëse deklaron nën përgjegjësinë personale se pas nënshkrimit të kësaj kontrate heq dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në cilësinë e ortakut të shoqërisë mbi pjesën e saj takuese të kuotës, të cilat nëpërmjet kësaj kontrate i kalojnë palës blerëse dhe e bëjnë **Z. Bledar Bregu ortak me 50% të kuotës së kapitalit të shoqërisë "HASTA ENGINEERING" sh.p.k.**

#### **Neni 5- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo lloj mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **Neni 6 – Të ndryshme**

Për sa më sipër, **Z. Bledar Bregu** pranon blerjen e 50% të kuotës së shoqërisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore të cilat kanë lindur në momentin e blerjes dhe do të lindnin në vazhdim si pasojë e zotërimit të kuotës, përfshirë detyrimet ndaj institucioneve shtetërore (tatim mbi vlerën e shtuar, tatim mbi të ardhurat, tatim në burim, taksat dhe tarifat vendore, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore, gjobat dhe kamatvonesat, faturime nga OSHEE dhe UKT etj.); ndaj punëmarrësve (pagat dhe cdo detyrim i cili rrjedh nga ligji dhe kontrata e punës); ndaj të tretëve, shoqëri tregëtare dhe person fizik (cdo e drejtëedetyrim i cili rrjedh nga kontratë qiraje, shërbimi, enfitheoze, leasing, kredi, huaje etj.) apo cdo e drejtëedetyrim ndaj shoqërive tregëtare dhe/ose organizate jo-qeveritare brenda dhe jashtë territorit shqiptar, përfshirë çdo të drejtëedetyrim i cila nuk është përmendur shprehimisht në këtë kontratë dhe në mënyrë ligjore ose edhe kontraktuale i takon shoqërisë "Hasta Engineering" shpk.

#### **Neni 7 - Regjistrimi i kontratës në institucionet përkatëse dhe ndryshimi i statutit**

Pala shitëse deklaron se është dakort që pala blerëse të mund të kryej të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e kësaj kontrate në institucionet përkatëse (sikurse QKB) si dhe paraqitjen e saj në institucione ku është e nevojshme (banka, bashki, komunë, institucione private, etj.). Gjithashtu pala blerëse, si ortakë e vetme e kësaj shoqërie, ka të drejtë të kryej ndryshimet e nevojshme në statutin e shoqërisë (dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm) dhe regjistrimin e statutit pranë QKB sipas rregullave në fuqi.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj në institucionet përkatëse (QKB, etj), ortakëria e shoqërisë "**HASTA ENGINEERING**" sh.p.k do të rezultojë:

**I. Z. Bledar BREGU- ortak me 50 % (pesëdhjetë përqind) të kuotës.**

**II. Znj. Luljeta LEJMONI- ortak me 50 % (pesëdhjetë përqind) të kuotës.**

Palet bien dakord që depozitimi i aplikimit përkatës për regjistrimin e kalimit të pronësisë në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit do të kryhet brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj





A2023051380036636554

kontrate. Palët janë të vetëdijshme se kjo kontratë duhet regjistruar në QKB brenda 30 ditë pune nga nënshkrimi për shkak publikimi. Kontrata është e vlefshme për palët që nga momenti i nënshkrimit të saj.

### Neni 8 - Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Çdo lloj mosmarreveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj kontrate, do të zgjidhet me mirkuptim ndërmjet palëve. Në të kundërt kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarreveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Kontrata u lexua qartë në prani të palëve, të cilët deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje noteres. Kontrata u hartua në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje me vlera të njëjta juridike mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese. Unë noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

#### PALA SHITËSE

Znj. Ermela KURTI

Në cilësinë e ortakut të shoqërisë  
"HASTA ENGINEERING" sh.p.k



#### PALA BLERËSE

Z. Bledar BREGU

#### DHËNES PËLQIMI

Znj. Luljeta LEJMONI

Në cilësinë e ortakut të shoqërisë  
"HASTA ENGINEERING" sh.p.k



NOTER  
STELA R. DEMNERI





## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

|                                                                                  |                                                                                                                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)                                | M11511002J                                                                                                        |
| 2. Data e Regjistrimit                                                           | 11/03/2021                                                                                                        |
| 3. Emri i Subjektit                                                              | HASTA ENGINEERING                                                                                                 |
| 4. Forma ligjore                                                                 | SHPK                                                                                                              |
| 5. Data e themelimit                                                             | 01/03/2021                                                                                                        |
| 6. Kohëzgjatja                                                                   | Nga: 01/03/2021                                                                                                   |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri                                         | Tirane Tirane TIRANE Rruga Fadil Deliu, Kompleksi Gjoka, Shkalla Nr.2, Kati I, Ap.3                               |
| 8. Kapitali                                                                      | 500.000,00                                                                                                        |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave                                               | 2,00                                                                                                              |
| 9. Objekti i aktivitetit                                                         | Projektim, zbatim. Te punimeve ne fushat e inxhinierive dhe arkitekturore dhe te gjitha fushave te lidhura me to. |
| 10. Administratori/ët                                                            | Bledar Bregu                                                                                                      |
| 10.1 Afati i emërimit                                                            | Nga: 01/03/2021 Deri: 01/03/2026                                                                                  |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore                  |                                                                                                                   |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)                                          |                                                                                                                   |
| 12. Ortakët                                                                      | LuljetaLejmoni                                                                                                    |
| 12.1 Vlera e kapitalit                                                           | Para: 250.000,00 Natyre:                                                                                          |
| 12.2 Numri i pjesëve                                                             | 1,00                                                                                                              |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)                                                | 50,00                                                                                                             |
| <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i> |                                                                                                                   |
| 13. Ortakët                                                                      | ErmelaKurti                                                                                                       |
| 13.1 Vlera e kapitalit                                                           | Para: 250.000,00 Natyre:                                                                                          |
| 13.2 Numri i pjesëve                                                             | 1,00                                                                                                              |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)                                                | 50,00                                                                                                             |
| <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i> |                                                                                                                   |



|                                                |                                                                                                                                                                                                    |
|------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit |                                                                                                                                                                                                    |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht        | Emri Tregtar: HASTA ENGINEERING<br>Web site: <a href="http://www.hastashpk.com">www.hastashpk.com</a><br>E-Mail: <a href="mailto:info@hastashpk.com">info@hastashpk.com</a><br>Telefon: 0676035306 |
| 16. Statusi:                                   | Aktiv                                                                                                                                                                                              |

Datë: 15/03/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



Vendim. Nr. 1

VENDIM

Asambleja ePërgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë  
"HASTA ENGINEERING" sh.p.k, NUIS M11511002J

Sot, me datë 14 / 03 /2023, Asambleja e shoqërisë "HASTA ENGINEERING" sh.p.k (në vijim 'shoqëria'), shoqëri e krijuar dhe e cila funksionon në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar sipas parashikimeve ligjore në institucionet përkatëse, me seli në TIRANE Rruga Fadil Deliu, Kompleksi Gjoka, Shkalla Nr.2, Kati I, Ap.3, NUIS M11511002J, u mbledh për të shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me pikat e mëposhtme të rendit të ditës. Te pranishem ne mbledhje ishin ortakët qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te shoqerise:

- **Znj. Ermela Kurti**, atësia Vangjel, amësia Ndone, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, me adresë Yzberish, Rr.'dhaskal Todri'; Nd. Ap.11; H. Shk.2; Kashar; Kashar; 1052; Tiranë, lindur më 30/12/1982, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033129783 dhe nr. personal I26230013C, në cilësinë e ortakut **me 50% të kuotës së shoqërisë "HASTA ENGINEERING" sh.p.k**,
- **Znj. Luljeta Lejmoni**, atësia Dhimitër, amësia Agllai, shtetas Shqiptar, lindur në Përmet dhe banues në Tiranë, me adresë adresë Artan Lenja; Nd. 17; H. 01; Ap. 01; Njësia Administrative Nr. 7; Tiranë, lindur më 05/11/1983, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Leternjoftim ID nr. personal **I36105018H**, në cilësinë e ortakut me 50% të kuotës së shoqërisë "HASTA ENGINEERING" sh.p.k,

Ortakët e mesiperm u mbledhen ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme per te diskutuar ceshtjet si me poshte:

1. Të miratojë: kalimin nëpërmjet shitjes të 50 % (pesëdhjetë përqind) të kuotës së ortakut **Znj. Ermela Kurti**, e cila korespondon me 50 % të kapitalit total të shoqërisë me cmim ALL 500,000 (pesëqind mijë Lekë). Blerësi i kësaj kuote do të jetë **Z. Bledar Bregu**, NID **I20313036P**.
2. Kontrata e shitjes do të nënshkruhet nga të gjitha palët (dy ortakët dhe blerësi)
3. Kontrata e shitjes do të regjistrohet në QKB nga administrator i shoqërisë Bledar Bregu.

VENDOSI:

1. Të pranojë kalimin nëpërmjet shitjes të 50 % (pesëdhjetë përqind) të kuotës nga **Znj. Ermela Kurti** tek **Z. Bledar Bregu**, NID **I20313036P**. Vlera e shitjes së kuotës të jetë ALL 500,000 (pesëqind mijë Lekë).
2. Kontrata të nënshkruhet nga të gjitha palët (dy ortakët dhe blerësi).
3. Kontrata e shitjes të regjistrohet në QKB nga administrator i shoqërisë Bledar Bregu.

Me përmbushjen e detyrimeve të palëve - pra me nënshkrimin e kontratës për kalim kuotash dhe regjistrimin e saj në institucionet përkatëse, ortakëria e shoqërisë do të rezultojë:

- I. **. Bledar BREGU- ortak me 50 % (pesëdhjetë përqind) të kuotës.**
- II. **Znj. Luljeta LEJMONI- ortak me 50 % (pesëdhjetë përqind) të kuotës.**

Duke mos patur çeshtje të tjera për të diskutuar dhe vendosur, mbledhja e Asamblesë u mbyll.

Asambleja ePërgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë  
"HASTA ENGINEERING" sh.p.k

Znj. Ermela Kurti

*Ermela Kurti*  


Znj. Luljeta Lejmoni

*Luljeta Lejmoni*  
